



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE  
ZHVILLIMIT TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË  
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN  
E MINIERAVE DHE INDUSTRIËS**

Nr. 1808/prot.

Tiranë, më 18.05.2020

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.722/1, datë 23.05.2014.

**SHOQËRISË “SHQIPONJA G” SH.P.K  
Shushicë, Bashkia Elbasan.**

**Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE  
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.**

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA  
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.**

Shoqëria “Shqiponja G” sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.722/1, datë 23.05.2014, për mineral gurë gëlqeror, në objektin “Shushice Elbasan”.

Nga struktura përgjegjëse e AKBN-së me shkresën nr.1378, datë 18.02.2020, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me nr.1908, datë 19.02.2020, është propozuar revokimi i lejes shfrytëzimit nr nr.722/1, datë 23.05.2014, për mineral gurë gëlqeror, në objektin “Shushicë Elbasan”, sepse nuk keni paguar garancinë financiare të rehabilitimit të mjedisit për vitin 2019, duke mos respektuar kërkesat e nenit 31, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në germën “c” e germën “ç” të pikës 1, të nenit 47, (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet), të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.722/1, datë 23.05.2014, për mineral gurë gëlqeror, në objektin “Shushice Elbasan”, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes minerare të shfrytëzimit nr.722/1, datë 23.05.2014, për mineral gurë gëlqeror, në objektin “Shushice Elbasan”.

Në zbatim të nenit 49, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!

**MINISTRI**  
**BELINDA BALLUKU**  
**ME AUTORIZIM**  
**ZËVENDËSMINISTRI**  
**ILIR BEJTJA**

